



Prishtinë: 29.03.2018

Kodi i ZRRE-së: V\_947\_2018

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_1631\_07\_17**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **12.10.2017**.

### në seancën e mbajtur më datë 29.03.2018, nxori këtë:

#### V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin A.H., nga Prishtina, me shifër të konsumatorit **DPR – 90109839** si e pa bazuar.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK\_V\_1631\_09\_17 i datës 21.09.2017.

#### A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 18.07.2017 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkallës së parë për këto shkaqe: faturimi i muajit 01/2016 është faturim real dhe është për periudhën 08.11.2015 e deri më 29.01.2016, dhe se gjatë kësaj periudhe energjia e faturuar nga vendosja e deri më 17.12.2015 është bërë në grupin matës, ndërsa pas kësaj date nuk është regjistruar në grupin matës dhe për këtë është bërë korigjimi. Në ankesë po ashtu theksohet se DMK ka gabuar kur ka theksuar se shpenzimi në periudhën 02/2016 e deri më 07/2017 është 6526.21 kWh ndërsa vetëm fatura e muajit 01/2016 është 14000 kWh dhe se ka disproporcion të shpenzimit. Gjithashtu është theksuar se çfarëdo faturimi i dyfishtë që ka ndodhur është faturim i dyfishtë për shifrën e që ka ekzistuar më parë DPR – 90041561 dhe nuk ka të bëjë me faturim të dyfishtë për 6 njehsorët e involvuar.

Bazuar në këtë KESCO kërkon nga Bordi që të pezulloi vendimin e DMK/ZRRE\_V\_1631\_09\_17, në lidhje me shifrën DPR - 90109839 si të pabazuar.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 29.03.2018 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejt dhe i bazuar në prova konkrete.



Lidhur me pretendimet e përfaqësuesit të KESCO-së, se faturimi i muajit 01/2016 dhe korrigjimi i bërë me datë 02.03.2016 është në përputhshmëri me dispozita ligjore të rregullave në fuqi, për Bordin pretendimet të tilla janë vlerësuar si të paqëndrueshme për faktin se nga analiza e bërë rrjedhës së energjisë elektrike dhe shkresave të lëndës nuk ka rezultuar se konsumatori të ketë shpenzuar atë energji elektrike të faturuar për muajin 01/2016.

Sa i përket pikës së kundërshtimit se faturimi i muajit 01/2016 është faturim real dhe se pasqyron shpenzimin nga kyçja e deri te data 29.01.2016, Bordi i ZRRE-së thekson se shifra DPR – 90109839 për herë të parë është regjistruar me datë 21.01.2016 në emër të A.H., ndërsa fatura e parë konsumatorit në këtë shifër i ka arritur në muajin 01/2016 me shpenzim prej 14,000 kWh apo llogaritur në vlerë financiare prej 2,171.10€. Bordi i ZRRE-së gjatë analizimit të shkresave të lëndës ka vërejtur se procesi i regjistrimit të njehsorit elektrik nr. 64448260 nr.0088148 të datës 12.01.2016 dhe nr.059904 të datës 12.01.2016 nuk përputhen me korrigjimin e bërë nga KESCO me datë 02.03.2016, si dhe me pikat 1, 2, 3 dhe 4 të ankesës së KESCO ndaj vendimit të shkallës së parë pasi që korrigjimi i KESCO i bërë me datë 02.03.2016 paraqet shpërndarjen e shpenzimit të energjisë elektrike prej periudhës 09/2015 e deri më 01/2016.

Bordi i ZRRE gjatë analizës së bërë shkresave të lëndës ka vërejtur se te rasti i konsumatorit ekzistojnë dy procesverbale të regjistrimit të njehsorit elektirk nr. 64448260 të bërë nga vet KEDS-it. Në procesverbalin e pranimit të instalimit të njehsorit elektrik të KEDS-it nr.0088148 të datës 12.01.2016 punëtorët e autorizuar të KEDS-it kanë evidentuar se bëhet regjistrimi i njehsorit elektrik nr.64448260 me gjendje TL=009898 kWh (tarifa e lartë) dhe TU=001117 kWh (tarifa e ulët), si dhe që kemi të bëjmë me konsumator komercial të kyçur në rrjetin elektrik në 0.4kV dhe ka Pëlqimin elektroenergjetik nr.8707 të datës 21.10.2015. Gjatë analizës së bërë procesverbalit të lartcekur vërehet se punëtorët e autorizuar të KEDS-it në procesverbal kanë theksuar se bëhet regjistrimi i njehsorit elektrik me gjendje fillestare I-009898 dhe II-001117 sepse ka qenë deri tash me njehsor 5 A, si dhe teknikisht njehsori ka qenë në rregull. Në procesverbalin tjetër të pranimit të instalimit të njehsorit elektrik të KEDS-it nr.059904 të datës 12.01.2016 punëtorët e autorizuar të KEDS-it kanë evidentuar për regjistrim njehsorin nr.64447885 me gjendje TL=000000/9898 kWh dhe TU=000000/1117 kWh, si dhe që kemi të bëjmë me konsumator komercial të kyçur në rrjetin elektrik në 0.4kV dhe ka Pëlqimin elektroenergjetik nr.8707 të datës 22.10.2015. Gjatë analizës së bërë këtij procesverbalit të KEDS-it vërehet se punëtorët e autorizuar të KEDS-it në procesverbal kanë theksuar se njehsori elektrik teknikisht është në rregull. Pra nga kjo shihet qartë se për njehsorin elektrik nr.64448260 kemi dy procesverbale të regjistrimit të njehsorit elektrik nga vet KEDS dhe se janë kontradiktore në mes vete dhe se për këtë nuk është dhënë asnjë sqarim.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe Pëlqimin Elektroenergjetik (PEE) nr.8707 të datës 22.10.2015 në të cilën theksohet se me kërkesë të palës bëhet ndarja e matjes së energjisë elektrike, dhe se në pikën tre të PEE është theksuar se matja e energjisë elektrike bëhet veçmas për secilën lokal me njehsor elektrike 3x230/400V, 5-100 (120) A, ndërsa njehsori elektrik ekzistues nr.96256351 mbetet si njehsor elektrik kontrollues. Pra nga PEE shihet qartë se njehsori elektrik nr.96256351 ka qenë regjistruar në shifrën DPR – 90041561 dhe se pas ndarjes së lokaleve, ky njehsor ka mbetur vetëm njehsor kontrollues.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO se organi i shkallës së parë ka bërë gabim në konstatimin e shpenzimit të energjisë elektrike, sepse fatura 01/2016 është për muajin 11/2015 dhe faturat 12/2015 dhe 01/2016 janë me mesatare 7978 kWh/muaj dhe është përafro me shpenzimin e muajve pasues 04/2016, 05/2016, 06/2016 që është mbi 4666.66 kWh dhe është shpenzim më i vogël se sa mesatarja e dhënë nga organi i shkallës së parë. Lidhur me këtë pikë, Bordi i ZRRE ka analizuar shpenzimin e energjisë elektrike të konsumatorit me shifër DPR – 90109839 dhe ka vërejtur se organi i shkallës së parë saktë ka bërë krahasimin e shpenzimeve ngase mesatarja mujore e shpenzimit të



energjisë elektrike prej periudhës 02/2016 e deri më 08/2017 është 6,526.21 kWh duke mos e përfshirë periudhën kontestuese (01/2016), ndërsa shpenzimi i faturuar për muajin 01/2016 është **14,000 kWh**.

Bordi i ZRRE gjatë analizimit të shkresave të lëndës konstaton se KESCO ka gabuar te konsumatori kur ka faturuar konsumatorin me gjithë shpenzimin e energjisë elektrike të muajit 01/2016, pasi sipas të dhënave të procesverbalit të KEDS-it nr.0088148 të datës 12.01.2016 kjo pikë matëse është dashur të faturohet nga data 12.01.2016, andaj edhe fatura e muajit 01/2016 duhet të korrigojohet dhe t'i bëhet konsumatorit zbritja e shpenzimit të energjisë elektrike (kilovatorët - kWh) të evidentuar në procesverbalin nr.0088148 të datës 12.01.2016. Pra, gjendja e shpenzimit të energjisë elektrike gjatë faturimit të muajit 01/2016 me datë 29.01.2016 ka qenë TL=12757 kWh dhe TU=1243 kWh, ndërsa gjendja fillesatare e regjistruar e njehsorit elektrik nr.64448260 me datë 12.01.2016 ka qenë TL=9818 kWh dhe TU=1117 kWh, andaj diferenca e këtij shpenzimit për të cilën konsumatori me shifër DPR – 90109839 duhet të faturohet është TL=2859 kWh dhe TU=126 kWh.

Bordi i ZRRE gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejt dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 29.03.2018 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

**III.** Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

**IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i Rregullatorit:**

\_\_\_\_\_  
Arsim Janova, u.d. kryesues

\_\_\_\_\_  
Besim Sejfiqaj, anëtar

\_\_\_\_\_  
Selman Hoti, anëtar

\_\_\_\_\_  
Izet Rushiti, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit A.H. (parashtruesi J.R.) dhe,
- Arkivit të ZRRE-së.